



Mars 2018

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nentor

Mars

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars 2018

© Ministria e Financave, 2018

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [vivi.besho@financa.gov.al](mailto:vivi.besho@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Mars 2018 arriti në 106.7 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Mars 2018 ishte 2.0 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Mars 2018 ishte 106.43 lekë për dollarë dhe 131.27 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Mars 2018 shënuan kuotën 1.03 për qind për ato 12 –mujore; 0.55 për qind për depozitat 6-mujore; 0.27 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.93 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.84 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.01 për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,238,422 milionë lekë në muajin Mars, duke shënuar një rënie prej rreth 0.4 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të 2018-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 215.4 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Mars 2018 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 5,0 miliardë lekë, ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 4,3 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar-Mars 2018, arritën në rreth 105,295 miliardë lekë ose afërsisht 97% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 100,280 miliardë lekë ose 97 % e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*

# Zhvillimet Ekonomike


## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Mars 2018 ishte +2.0%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +2.1%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Mars 2018 shënoi rritje prej 0.3 për qind krahasuar me muajin paraardhës, në muajin shkurt pati po ashtu rritje prej 0.8 për qind. Përgjatë muajit Janar 2018, indeksi ka shënuar rritje prej 1.5 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Mars 2017 shënoi rritje 0.4 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +3.1%, duke kontribuar me +1.18 pikë përqindje; “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me një rritje vjetore të çmimit prej +2.2%, duke kontribuar me +0.45 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.0%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit nuk ka pasur kategori të cilat kanë ndikuar negativisht në



inflacionin e përgjithshëm përgjatë muajit mars 2018.

**Ndryshimi mujor i indeksit është +0.3%.** Krahasuar me muajin Shkurt 2018 rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 1.0%, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0.9%, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0.6%, etj. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” shënuan një ulje prej 0.9%, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0.4%.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2017</b>	2.8	2.2	2.1	1.9	2.0	2.2	2.0	1.6	1.6	1.9	1.7	1.8
<b>2018</b>	1.7	2.1	<b>2.0</b>									


Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Mars 2018, arriti në 131.27 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 1.10 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Mars, një euro u këmbye me 130.44 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Mars 2018 arriti në 106.43 lekë/dollarë duke shënuar rënie në vlerë me 0.90 për qind kundrejt muajit shkurt 2018. Në fund të muajit Mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 105.8 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Mars të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 3.01 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 16.01 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.81 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave



Gjatë muajit Mars 2018, normat e interesit të depozitave me afat 12 mujor shënuan vlerën më të lartë prej 1.03 për qind, pasuar nga ato me afat 1 dhe 6-mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.93 dhe 0.55 për qind. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 3 mujore arritën kuotën 0.27 për qind.

Normat e interesit të depozitave 6-mujore kanë shënuar rënie mujore me 0.20 dhe pikë përqindje. Ndërsa rritje mujore kanë shënuar normat e interesit të depozitave 12 dhe 6 dhe 1-mujore prej përkatësisht 0.23 dhe 0.02 dhe 0.17 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë shënuar normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6, 3 dhe 1-mujore, respektivisht me nga 0.03, 0,01 dhe 0.04 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 12-mujore kanë shënuar rritje me 0.13 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12-mujore gjatë muajit Mars 2018 arritën përkatësisht kuotën prej 8.01 dhe 6.84 për qind. Normat e interesit të huave 6-mujore kanë shënuar rënie mujore prej 0.51, ndërsa huatë 12-mujore kanë shënuar rritje prej 0.33 për qind. Po ashtu, krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 mujore kanë shënuar rënie prej 0.43 për qind, ndërsa huatë 12 mujore kanë shënuar rritje prej 0.13 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Mars 2018 arritën nivelin 2.51 për qind duke shënuar kështu rënie mujore prej 0.11 për qind dhe rritje vjetore prej 0.26 për qind.





## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2018 shënoi rritje të mjeteve valutore, me rreth 215.4 milionë euro. Tremujori i katërt i 2018-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 295 milionë euro, dhe vlerësohet në zgjerim me bazë vjetore (rreth 66%). Deficiti tregtar u zgjerua me rreth 30%, në nivelin 570 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 252 milionë euro në rritje me 123 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Flukset e kapitalit, shumat e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 374.9 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 2,808 milionë euro dhe janë zgjeruar me 7% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 295 milionë euro, në rritje vjetore me rreth 66%. Trendi pozitiv i llogarisë korrente ndryshoi kurs në këtë tremujor, si rezultat i zgjerimit të konsiderueshëm të deficitit tregtar, nxitur nga shpezime të larta të importeve në energji elektrike, ndërkohë që eksporti shënoi rënie të lehtë. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për tremujorin e katërt 2018 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -787.6 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 217.4 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 22.5 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 253.1 milionë euro.







## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Mars 2018, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 21,678 milionë lekë krahasuar me muajin Mars të vitit 2017. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së mjeteve valutore neto të bankës qendrore me rreth 31,532 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 11,556 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 11,952 milionë lekë të bankës qendrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,238,423 milionë lekë në muajin Mars 2018, duke shënuar rënie prej rreth 4,573 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rënie vjetore prej 0.4 për qind.

Në muajin Mars 2018, sistemi bankar rezulton me rënie prej 14,365 milionë lekë ose -1.1 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Mars 2018 arriti në rreth 548,185 milionë lekë. Balanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 753,7 milionë lekë, ose rritje prej rreth 0,14 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në lekë, duke përbërë rreth 50.1 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 274,632 milionë lekë.

Gjatë muajit Mars 2018, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 60.5 për qind ose 331,652 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 32.57 për qind ose 178,534 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 5.34 dhe 1.45 për qind apo 29,298 dhe 7,941 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin Mars 2018, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 71.7 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 25.0 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Korporata publike jofinanciare” kontribuojnë përkatësisht me rreth 1.5 për qind dhe rreth 1.7 për qind.



## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 254,440 milionë lekë në fund të muajit Mars 2018. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Mars 2018 ka shënuar rënie mujore prej 0.02 për qind si dhe rritje vjetore prej 0.87 për qind, duke arritur nivelin 20.5 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rënie mujore prej 0.03 për qind dhe rritje vjetore prej 1.37 për qind, duke shënuar nivelin 25.9 për qind.

Fig-11




Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Mars 2018, kanë pësuar rënie prej 1,124 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 81.2 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa depozitat në Lekë gjatë muajit Mars 2018 shënuan rënie prej 13,637 milionë lekë në krahasim me muajin Mars 2017. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 84.6 për qind të tyre.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë


## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Mars 2018, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 84.6 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 11.3 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.1 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 81.2 për qind dhe rreth 16.9 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 82.8 për qind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 814,450 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (140,343 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (14,551 milionë lekë) dhe “Korporata jofinanciare publike” (13,160 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,478 milionë lekë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Mars 2018, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 983,983 miliardë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 11,172 milionë lekë, po ashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rënie me 14,762 milionë lekë.


Fig-13



**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-14



**Përberja e depozitave Mars 2018**

Burimi: Banka e Shqipërisë


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Mars 2018 janë mbledhur rreth 105,295 miliardë lekë të ardhura, përkundëjt shpenzimeve të përgjithshme prej 100,280 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 89,7 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 10,5 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 53% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 72,1 miliardë lekë (ose rreth 95% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushtetit vendor rreth 3.5 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 22,4 miliardë lekë (ose rreth 107% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 6,5 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit të periudhës Janar-Mars 2018).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 89,8 miliardë lekë, 18,3 miliardë lekë (20% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 8,4 miliardë lekë (9%) për shpenzime interesi, 8,0 miliardë lekë (9%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje,



243 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 37,3 miliardë lekë (42%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 12,4 miliardë lekë (14%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 4,5 miliardë lekë (5%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 22% (shpenzime personeli), 20% (shpenzime për interesat), 18% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 12% (subvencione), 23% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 27% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 20% (shpenzimet e tjera) përkundëjt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 9%, ndërsa financimi i huaj është 18% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Mars 2018 ishin rreth 105,295 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 98,456 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 6,514 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Mars 2018 (mld Lekë) Revenues during March 2018 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Mars '18 March '18	Mars '17 March '17	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	11.7	11.0	11.7
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.5	0.4	5.7
	Akcizat (Excise)	3.4	3.5	-2.2
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	6.1	7.3	-16.6
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	2.5	2.2	12.5
	Taksat nacionale (National Tax)	2.4	2.3	2.9

*Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Mars – 2018*

*Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: March – 2018*

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 5,0 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Mars 2018, u mbështet kryesisht nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe nëpërmjet huasë afatgjatë të huaj.

Për muajin Mars 2018, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 37,740 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 36,426 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Mars 2018, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 35,2 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 32,3 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 4,0 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2014	2015	2016	2017	2018	2014	2015	2016	2017	2018	2014	2015	2016	2017	2018	
Janar	0.8	1.4	0.9	1.5	1.5	0.8	1.4	0.9	1.5	1.5	1.7	1.3	1.5	2.8	1.7	January
Shkurt	1.4	2.4	1.1	0.5	0.8	1.1	1.9	1.0	1.0	0.9	1.9	2.3	0.2	2.2	2.1	February
<b>Mars</b>	0.5	0.4	0.5	0.4	<b>0.3</b>	0.9	1.4	0.8	0.8	<b>0.9</b>	2.2	2.2	0.3	2.1	<b>2.0</b>	<b>March</b>
Prill	-0.6	-0.5	-0.4	-0.6		0.5	0.9	0.5	0.5		1.7	2.3	0.3	1.9		April
Maj	-1.1	-1.6	-1.2	-1.2		0.2	0.4	0.2	0.1		1.6	1.8	0.7	2.0		May
Qershor	-0.7	-1.1	-0.6	-0.4		0.1	0.1	0.04	0.0		1.5	1.4	1.2	2.2		June
Korrik	-0.6	-0.7	0.05	-0.14		0.0	0.2	0.26	0.0		1.8	1.3	1.9	2.0		July
Gusht	0.1	0.8	0.86	0.41		0.0	0.1	0.27	0.1		2.0	1.9	2.0	1.6		August
Shtator	0.3	0.6	0.40	0.36		0.0	0.2	0.17	0.1		1.5	2.2	1.8	1.6		September
Tetor	0.1	0.01	-0.2	0.0		0.0	0.2	0.13	0.1		1.4	2.1	1.5	1.9		October
Nëntor	-0.2	-0.3	0.1	-0.1		0.0	0.1	0.12	0.1		1.7	2.1	1.9	1.7		November
Dhjetor	0.7	0.6	0.9	1.0		0.1	0.17	0.19	0.2		0.7	2.0	2.2	1.8		December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2

## Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2014	2015	2016	2017	2018			Currency
					Janar	Shkurt	Mars	
					January	February	March	
<i>Mesatarja e periudhës</i>								<i>Average of period</i>
USD	113.64	126.64	128.29	112.56	109.52	107.39	106.43	USD
EURO	140.11	137.65	135.27	133.25	133.57	132.72	131.27	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>								<i>In the end of period</i>
USD	115.23	125.79	128.17	111.10	107.26	108.12	105.80	USD
EURO	140.14	137.28	135.23	132.95	133.44	132.23	130.44	EURO

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2014	2015	2016	2017	2018			
Në përqindje					Janar January	Shkurt February	Mars March	In percent
<b>Norma e depozitave</b>								Deposits rates
12-M	1.51	1.27	0.78	0.80	0.72	0.80	1.03	12-M
6-M	1.16	1.17	0.78	0.56	0.69	0.75	0.55	6-M
3-M	0.83	0.54	0.27	0.29	0.28	0.25	0.27	3-M
1-M	1.47	0.88	0.87	0.82	0.92	0.76	0.93	1-M
<b>Norma e huasë</b>								Lending rates
12-M	7.00	7.47	4.54	6.79	6.65	6.51	6.84	12-M
6-M	8.18	8.35	7.01	8.12	10.14	8.52	8.01	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>								Securities rates
Bono thesari 1/								Treasury bills 1/
3-M	3.15	-	-	-	1.31	-	-	3-M
6-M	3.16	2.46	2.00	-	-	2.04	-	6-M
12-M	3.33	2.40	2.92	2.63	2.71	2.62	2.51	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



## TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2018

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2018

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>35,391</b>	<b>67,555</b>	<b>105,295</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>92</b>	<b>365</b>	<b>325</b>	<b>Grands</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>33,116</b>	<b>63,182</b>	<b>98,456</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>22,858</b>	<b>45,099</b>	<b>72,131</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,139	21,896	33,614	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,424	3,542	9,674	Profit Tax
3	Akcizat	3,044	6,139	9,572	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,437	6,001	8,533	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,397	6,645	9,338	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	418	877	1,400	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,365</b>	<b>2,262</b>	<b>3,564</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	267	494	820	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	12	20	183	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,087	1,748	2,561	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>8,892</b>	<b>15,821</b>	<b>22,761</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	7,593	13,556	19,505	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,213	2,093	2,977	Health insurance
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>2,184</b>	<b>4,009</b>	<b>6,514</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë		0	900	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,656	2,989	4,209	Income of budgetary institutions
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>30,028</b>	<b>63,854</b>	<b>100,280</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>26,464</b>	<b>57,401</b>	<b>89,748</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>6,018</b>	<b>12,232</b>	<b>18,322</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	5,157	10,263	15,454	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	847	1,667	2,539	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>2,997</b>	<b>5,968</b>	<b>8,488</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	2,305	4,622	6,521	Domestic
2	Të Huaja	692	1,346	1,967	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,589</b>	<b>3,901</b>	<b>8,079</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveçionet</b>	<b>73</b>	<b>174</b>	<b>243</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>11,846</b>	<b>24,573</b>	<b>37,632</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	9,218	18,360	27,987	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,628	6,214	9,323	Health insurance
I.6	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>2,935</b>	<b>7,948</b>	<b>12,403</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,006</b>	<b>2,604</b>	<b>4,581</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	26	50	75	Unemployment insurance benefits
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>		0		<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>3,564</b>	<b>6,453</b>	<b>10,532</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	0	1,489	4,862	Domestically financing
2	Financimi Huaj	3,564	4,909	5,531	Foreign financed
IV	<b>Detyrimet e prapambetuara</b>				<b>Arrears</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>5,363</b>	<b>3,702</b>	<b>5,015</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-5,363</b>	<b>-3,702</b>	<b>-5,015</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-8,041</b>	<b>-6,633</b>	<b>-6,671</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	29	36	38	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	6,031	7,867	11,676	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-14,100	-14,536	-18,386	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>2,677</b>	<b>2,931</b>	<b>1,656</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	3,400	4,351	5,065	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua		87	106	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	68	288	146	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-791	-1,708	-3,556	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	-	-	-	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2018**

Table of investments 2018

*Të dhëna progresive (Progressive Data)**në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>8,041</b>	<b>- 6,633</b>	<b>6,671</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	149.92	179.16	133.02	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>2,677</b>	<b>2,931</b>	<b>1,656</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	-49.92	-79.16	-33.02	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>-5,363</b>	<b>-3,702</b>	<b>-5,015</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2018  
CUSTOMS REVENUES 2018**

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million Lek)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
Taksë doganore	418	877	1,400	Customs Duties
TVSH	7,665	15,169	24,366	V.A.T
Akcizë	3,044	6,139	9,572	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	234	503	758	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>11,361</b>	<b>22,688</b>	<b>36,097</b>	<b>Total</b>

**TË ARDHURAT TATIMORE 2017 (TAX REVENUE )**

TVSH	3,474	6,727	9,247	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,424	3,542	9,674	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,437	6,001	8,533	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,163	6,141	8,580	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>11,497</b>	<b>22,411</b>	<b>36,034</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>22,858</b>	<b>45,099</b>	<b>72,131</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

## DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2018

The Deficit and Its Financing for 2018

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>35,391</b>	<b>67,555</b>	<b>105,295</b>	<b>REVENUE</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>30,028</b>	<b>63,854</b>	<b>100,280</b>	<b>EXPENDITURES</b>
<b>BILANCI FISKAL</b>	<b>5,363</b>	<b>3,702</b>	<b>5,015</b>	<b>FISCAL BALANCE</b>
<b>FINANCIMI I BILANCIT FISKAL</b>	<b>-5,363</b>	<b>-3,702</b>	<b>-5,015</b>	<b>FINANCING</b>
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>-8,041</b>	<b>-6,633</b>	<b>-6,671</b>	<b>Domestic</b>
a. Bono Thesari Neto	1,893	3,172	3,126	Treasury bills
b. Obligacione	4,150	4,718	8,585	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	-10,196	-9,926	-11,312	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-10,694	-10,576	-12,794	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	499	650	1,482	Deposit of Social & Health Ins.
d.Mjete në ruajtje	-549	-830	-835	Non-budget revenues
e.Të ardhura nga privatizimi	29	36	38	Privatization receipts
f.Të tjera detyrime	-3,361	-3,760	-6,238	Others
g.Huamarrje Brendshme Vendori	-12	-22	-35	Local Borrowing
<b>Financimi i jashtëm</b>	<b>2,677</b>	<b>2,931</b>	<b>1,656</b>	<b>Foreing</b>
a. Hua afatgjatë	3,400	4,351	5,065	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	68	288	146	Chang. of stat. Account
c.Ripagesat	-791	-1,708	-3,556	Repayments
d.Mbeshtetje Buxhetore	0	0	0	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	3M_I_2017	3M_II_2017	3M_III_2017	3M_IV_2017	
<b>Llogaria korentë</b>	<b>-1,026.70</b>	<b>-1,303.20</b>	<b>-1,160.50</b>	<b>-1,029.70</b>	<b>-151.60</b>	<b>-236.20</b>	<b>-120.70</b>	<b>-294.60</b>	<b>Current Account.</b>
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-1,729.30</b>	<b>-2,136.60</b>	<b>-2,298.80</b>	<b>-2,602.80</b>	<b>-587.10</b>	<b>-695.30</b>	<b>-753.80</b>	<b>-787.60</b>	<b>Trade Balance.</b>
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	925.30	771.10	713.70	181.30	216.40	183.80	215.70	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-3,061.90	-3,069.90	-3,316.50	-768.40	-911.70	-937.60	-1,003.30	Merchandise Imports. Fob
<b>Bilanci i shërbimeve</b>	<b>8.90</b>	<b>268.40</b>	<b>502.80</b>	<b>796.60</b>	<b>275.40</b>	<b>209.20</b>	<b>380.20</b>	<b>217.40</b>	<b>Services Balance.</b>
Shërbimet Kredi	1,655.00	2,031.50	2,028.20	2,395.70	591.90	677.80	926.30	659.90	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	1,763.10	1,503.30	1,599.10	316.50	468.60	546.10	442.50	Services Debt
<b>Bilanci i të ardhurave</b>	<b>-8.40</b>	<b>-159.60</b>	<b>-133.00</b>	<b>-44.10</b>	<b>-8.90</b>	<b>36.40</b>	<b>40.70</b>	<b>22.50</b>	<b>Balance of Incomes</b>
Të ardhurat Kredi	193.30	110.60	126.00	177.10	79.60	122.90	106.60	96.30	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-270.20	-259.00	-221.20	-88.50	-86.50	-65.90	-73.80	Income Debt
<b>Bilanci i transfertave</b>	<b>702.10</b>	<b>724.60</b>	<b>768.50</b>	<b>820.60</b>	<b>169.00</b>	<b>213.50</b>	<b>212.20</b>	<b>253.10</b>	<b>Balance of Transfers</b>
Transferta private	681.40	851.80	921.50	961.20	198.30	242.20	236.70	284.70	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	20.70	-127.20	-153.00	-140.60	-29.30	-28.70	-24.50	-31.60	Official Unrequired Transfers
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>47.70</b>	<b>86.70</b>	<b>125.70</b>	<b>66.30</b>	<b>23.80</b>	<b>25.30</b>	<b>30.40</b>	<b>42.90</b>	<b>Capital Account</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>775.60</b>	<b>-956.30</b>	<b>-1,326.20</b>	<b>-712.60</b>	<b>-303.20</b>	<b>-121.90</b>	<b>-253.80</b>	<b>-417.80</b>	<b>Financial Account</b>
Investime direkte	893.10	-801.30	-823.00	-958.40	-202.60	-217.60	-334.00	-218.40	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	120.80	-324.80	204.60	-139.00	-21.60	31.20	27.90	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-275.80	-88.50	181.60	110.10	117.10	48.10	-227.40	Other Capital
<b>Gabime dhe harresa neto</b>	<b>315.30</b>	<b>311.00</b>	<b>296.00</b>	<b>298.80</b>	<b>-166.70</b>	<b>13.00</b>	<b>-125.70</b>	<b>49.30</b>	<b>Net errors and omissions</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>111.90</b>	<b>50.80</b>	<b>259.50</b>	<b>48.00</b>	<b>8.70</b>	<b>-76.00</b>	<b>37.80</b>	<b>215.40</b>	<b>Overall Balance</b>
		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>						
Rezervat	-104.40	97.20	609.60	47.60	8.60	-76.20	37.60	215.40	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	46.40	89.90	140.40	71.70	-0.20	-0.90	-0.10	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**MJETET VALUTORE NETO**

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2015	2016	2017	2018			Millions of Lek End of Period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	
Mjetet valutore neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	373,917.9	373,896.2	361,943.9	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	407,654.7	418,562.1	417,605.4	401,225.0	400,897.4	388,762.3	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	41,991.5	28,949.4	26,917.8	27,307.1	27,001.2	26,818.4	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	63,394	65,915.7	59,998	52,048	47,990	48,386	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	48,752	34,255.6	18,407	3,041	5,588	4,548	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	75,143.9	53,279.9	52,839.5	48,388.1	50,695.0	51,432.9	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	26,391.9	19,024.3	34,432.8	45,347.5	45,107.3	46,884.6	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	12,237.0	29,934.4	39,871.3	47,288.0	40,691.2	42,134.4	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,648.9	1,725.7	1,720.0	1,719.6	1,711.3	1,704.0	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	383,972.8	414,380.9	452,243.1	402,929.6	399,233.0	392,310.1	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	451.8	194.0	146.6	133.9	133.5	127.4	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	34.2	47.2	96.8	50.2	17.5	34.4	Other accounts payable
Të tjera neto	-18,792	-20,953.6	-20,683	-20,718	-20,696	-20,668	Other items net
Aksione	63,391.1	61,859.9	45,882.2	43,571.0	43,198.7	38,526.2	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË**  
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018			Million of Lek End of Period
				Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Totali i kredisë</b>	<b>546,873</b>	<b>547,602.4</b>	<b>550,280.4</b>	<b>550,796.8</b>	<b>549,941.3</b>	<b>548,184.9</b>	<b>Total Credit</b>
<b>Kredia për qeverinë lokale</b>	<b>887.7</b>	<b>845.5</b>	<b>787.7</b>	<b>776.1</b>	<b>771.5</b>	<b>760.6</b>	<b>Credits to local Government</b>
Në lekë	887.7	845.5	787.7	776.1	771.5	760.6	in Lek
Në valutë	-	-	0.0	-	-	-	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare publike</b>	<b>27,419.7</b>	<b>26,863.9</b>	<b>29,515.4</b>	<b>29,555.4</b>	<b>28,893.7</b>	<b>29,298.0</b>	<b>Credits to Public Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	22,326.1	23,993.9	24,453.5	24,456.8	23,869.9	24,439.2	in Lek
Në valutë	5,093.6	2,870.0	5,061.9	5,098.6	5,023.8	4,858.8	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare private</b>	<b>355,725.2</b>	<b>343,483.0</b>	<b>334,762.9</b>	<b>334,304.0</b>	<b>334,129.0</b>	<b>331,651.7</b>	<b>Credits to other Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	129,233.7	131,743.5	136,075.7	134,717.3	134,616.4	135,420.6	in Lek
Në valutë	226,491.5	211,739.5	198,687.2	199,586.7	199,512.6	196,231.1	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera financiare</b>	<b>9,537.7</b>	<b>8,687.6</b>	<b>7,944.6</b>	<b>8,028.3</b>	<b>7,866.9</b>	<b>7,940.7</b>	<b>Credits to Other Financial Corporations</b>
Në Lekë	5,036.2	4,242.3	3,522.3	3,387.3	3,387.4	3,659.0	in Lek
Në valute	4,501.5	4,445.3	4,422.3	4,641.0	4,479.5	4,281.7	in Foreign Currency
<b>Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë</b>	<b>153,303.1</b>	<b>167,722.4</b>	<b>177,269.8</b>	<b>178,133.0</b>	<b>178,280.2</b>	<b>178,533.9</b>	<b>Claims to other Resident Sectors</b>
Në Lekë	83,319.7	98,722.3	108,419.1	108,800.0	109,523.7	110,352.1	in Lek
Në valutë	69,983.4	69,000.1	68,850.7	69,333.0	68,756.5	68,181.8	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**  
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2014	2015	2016	2017	2018			Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Baza monetare</b>	<b>332,899.3</b>	<b>383,972.8</b>	<b>414,380.9</b>	<b>425,243.1</b>	<b>402,929.6</b>	<b>399,233.0</b>	<b>392,310.1</b>	<b>Base Money</b>
Ndryshimi vjetor në %	8.1	15.3	1.1	1.0	1.0	1.1	1.0	Y/Y change in %
<b>Paraja jashtë korporatave depozituese</b>	<b>217,665.6</b>	<b>239,218.1</b>	<b>249,256.5</b>	<b>265,156.0</b>	<b>257,398.9</b>	<b>257,631.9</b>	<b>254,439.3</b>	<b>Currency Outside Depository</b>
Ndryshimi vjetor në %	9.4	9.9	4.2	6.4	4.5	5.3	4.0	Y/Y change in %
<b>Depozita</b>	<b>977,420</b>	<b>687,292.6</b>	<b>737,808</b>	<b>741,157</b>	<b>740,867.8</b>	<b>737,135.7</b>	<b>728,369.2</b>	<b>Deposits</b>
Ndryshimi vjetor në %	2.9	-29.7	7.3	0.5	0.5	0.9	-12.3	Y/Y change in %
<b>Agregati M1</b>	<b>353,321.7</b>	<b>384,106.9</b>	<b>435,432.3</b>	<b>461,550.1</b>	<b>451,804.2</b>	<b>453,728.7</b>	<b>433,566.2</b>	<b>M1 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	19.4	8.7	13.4	6.0	4.9	6.9	4.4	Y/Y change in %
<b>Agregati M2</b>	<b>722,356.7</b>	<b>723,975.7</b>	<b>736,944.1</b>	<b>738,900.0</b>	<b>725,453.0</b>	<b>725,355.9</b>	<b>715,263.8</b>	<b>M2 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	4.2	0.2	1.9	0.3	-0.5	0.4	-0.5	Y/Y change in %
<b>Agregati M3</b>	<b>1,195,086.3</b>	<b>1,218,101.2</b>	<b>1,263,453.8</b>	<b>1,266,906.9</b>	<b>1,259,090.4</b>	<b>1,252,787.9</b>	<b>1,238,422.6</b>	<b>M3 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	4.0	1.9	3.9	0.3	-0.1	0.4	-0.4	Y/Y change in %
<b>Burimet e bazës monetare</b>								<b>Monetary Base sources</b>
Mjetet e huaja neto	292,098.3	365,663.3	389,612.7	390,687.6	373,917.9	373,896.2	361,943.9	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	82,525.1	63,394.2	65,915.7	59,998.0	52,048.3	47,990.1	48,386.4	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	55,198.3	48,752.0	34,255.6	18,406.7	3,040.7	5,587.7	4,548.0	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	25,547.8	12,987.1	29,934.4	39,871.3	47,288.0	40,691.2	42,134.4	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



## DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2014	2015	2016	2017	2018			Millions of Leks End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>Në lekë</b>	<b>504,691</b>	<b>493,374</b>	<b>487,687</b>	<b>473,744</b>	<b>468,054</b>	<b>467,724</b>	<b>460,825</b>	<b>In national currency</b>
<b>Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë</b>	<b>135,656</b>	<b>153,506</b>	<b>186,176</b>	<b>196,394</b>	<b>194,406</b>	<b>196,097</b>	<b>189,127</b>	<b>Transferable deposits+Liquid deposits</b>
Qeveria lokale	2,047.5	1,473.8	1,907.5	1,344.4	1,440.3	1,440.3	1,400.3	Local governments
Korporata jofinanciare publike	9,799.5	8,736.2	6,786.0	8,656.7	8,540.4	9,176.2	7,985.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,919.8	1,258.9	2,071.0	2,524.8	2,878.0	4,141.0	3,204.0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	38,198.6	40,993.6	46,051.0	48,979.3	49,398.4	47,978.6	42,610.3	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	83,690.6	101,043.0	129,360.4	134,889.0	132,148.4	133,360.6	133,926.8	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>369,035</b>	<b>339,869</b>	<b>301,512</b>	<b>277,350</b>	<b>273,649</b>	<b>271,627</b>	<b>271,698</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale	7.8	29.9	18.9	15.2	23.2	23.2	23.2	Local governments
Korporata jofinanciare publike	1,167.9	815.0	976.8	705.2	736.1	737.1	1,651.7	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,730.1	3,573.4	7,553.4	9,282.1	5,714.7	4,877.6	4,695.8	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,772.0	11,292.1	6,502.2	9,062.4	10,088.0	9,495.0	9,484.8	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	354,357.3	324,158.3	286,460.2	258,285.1	257,086.5	256,494.3	255,842.0	Other resident sectors
<b>Në valutë</b>	<b>472,729</b>	<b>193,918</b>	<b>250,121</b>	<b>267,413</b>	<b>272,814</b>	<b>269,412</b>	<b>267,545</b>	<b>In foreign currency</b>
Qeveria lokale	231.3	209.5	366.1	139.8	167.5	184.1	54.9	Local governments
Korporata jofinanciare publike	7,099.6	3,645.4	2,999.4	2,086.3	2,142.9	2,067.7	1,622.1	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	4,872.9	2,641.2	1,815.4	3,756.9	3,987.7	3,816.4	3,339.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	55,834.3	53,618.9	73,325.0	74,187.3	77,646.4	75,194.8	76,714.1	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	404,691.2	133,803.4	171,614.8	187,242.7	188,869.3	188,148.8	185,813.7	Other resident sectors
<b>Total</b>	<b>977,420</b>	<b>687,293</b>	<b>737,808</b>	<b>741,157</b>	<b>740,868</b>	<b>737,136</b>	<b>728,369</b>	<b>Total</b>
Qeveria lokale	2,286.6	1,713.2	2,292.5	1,499.4	1,631.0	1,647.6	1,478.4	Local governments
Korporata jofinanciare publike	18,067.0	13,196.6	10,762.2	11,448.2	11,419.4	11,981.0	11,259.4	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	8,522.8	7,473.5	11,439.8	15,563.8	12,580.4	12,835.0	11,239.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	105,804.9	105,904.6	125,878.2	132,229.0	137,132.8	132,668.4	128,809.2	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	842,739.1	559,004.7	587,435.4	580,416.8	578,104.2	578,003.7	575,582.5	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH**

Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës				2018			Millions of Lek End of period
	2015	2016	2017	Janar January	Shkurt February	Mars March	
<b>AKTIVET</b>	<b>516,358</b>	<b>524,731</b>	<b>532,927</b>	<b>519,506</b>	<b>514,845</b>	<b>504,853</b>	
<b>Total</b>	<b>126,386</b>	<b>131,887</b>	<b>187,367</b>	<b>175,831</b>	<b>177,397</b>	<b>175,013</b>	<b>Total</b>
Mbajtjet e SDR	30,578.8	27,211.8	25,725.3	24,080.7	23,851.6	23,383.7	SDR holdings
Arka në valutë	84.9	52.0	24.3	20.8	24.9	18.8	Foreign currency
Depozitat	95,722.4	104,622.9	161,617.3	151,729.1	153,520.5	151,610.0	Deposits
<b>Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet</b>	<b>323,679</b>	<b>315,113</b>	<b>259,538</b>	<b>249,916</b>	<b>250,350</b>	<b>241,899</b>	<b>Securities other than shares</b>
Jorezident	270,453.6	261,877.5	206,818.9	201,713.5	199,894.3	190,547.9	nonresidents
Qeveria qendrore	53,225.5	53,235.2	52,718.8	48,202.0	50,455.6	51,350.9	central government
<b>Huatë</b>	<b>14,641</b>	<b>31,660</b>	<b>41,591</b>	<b>49,007</b>	<b>42,401</b>	<b>43,838</b>	<b>Loans</b>
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	47,288.0	40,691.2	42,134.4	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,654.0	1,725.9	1,719.8	1,718.5	1,710.1	1,703.4	Other resident secotrs
<b>Derivatet financiare</b>	<b>27.7</b>	<b>15.8</b>	<b>11.7</b>	<b>9.9</b>	<b>11.1</b>	<b>11.2</b>	<b>Financial derivatives</b>
<b>Llogari të arketueshme</b>	<b>32,741.6</b>	<b>25,094.1</b>	<b>23,844.9</b>	<b>24,200.3</b>	<b>24,172.7</b>	<b>23,608.1</b>	<b>Receivable accounts</b>
<b>Mjetet jofinanciare</b>	<b>18,882.5</b>	<b>20,961.2</b>	<b>20,574.7</b>	<b>20,543.1</b>	<b>20,513.3</b>	<b>20,484.5</b>	<b>Nonfinancial assets</b>
<b>DETYRIMET</b>	<b>516,358</b>	<b>524,731</b>	<b>532,927</b>	<b>519,506</b>	<b>514,845</b>	<b>504,853</b>	<b>LIABILITIES</b>
<b>Total</b>	<b>241,006</b>	<b>262,031</b>	<b>278,611</b>	<b>269,621</b>	<b>269,772</b>	<b>266,520</b>	<b>Total</b>
Para në qarkullim	239,218.1	258,848.0	274,711.8	267,722.9	268,004.0	265,964.6	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	1,787.9	3,183.2	3,899.2	1,897.8	1,767.8	554.9	Deposits included in broad money
<b>Depozita të papërfshira në paranë e gjerë</b>	<b>201,586</b>	<b>191,380</b>	<b>200,514</b>	<b>198,054</b>	<b>193,974</b>	<b>192,087</b>	<b>Deposits excluded from broad money</b>
Jorezident	31,826.2	19,860.9	19,350.9	19,313.4	19,310.3	19,316.6	Nonresidents
Qeveria qendrore	26,340.8	18,975.1	34,384.3	45,297.6	45,068.7	46,852.5	Central government
Korporata të tjera depozituese	142,966.8	152,349.7	146,632.1	133,308.9	129,461.2	125,790.6	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	87.4	72.1	66.7	62.8	62.5	61.9	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	364.4	121.9	79.9	71.0	71.0	65.5	
<b>Huatë</b>	<b>1,810</b>	<b>314</b>	<b>116</b>	<b>95</b>	<b>77</b>	<b>75</b>	-
Jorezidentët	1,809.6	314.2	115.6	95.4	76.5	75.1	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
<b>Llogari të pagueshme</b>	<b>461.1</b>	<b>1,164.6</b>	<b>463.8</b>	<b>901.8</b>	<b>530.9</b>	<b>491.5</b>	<b>Other accounts payable</b>
<b>Alokimi i SDR</b>	<b>8,104.4</b>	<b>7,981.2</b>	<b>7,340.5</b>	<b>7,263.5</b>	<b>7,293.5</b>	<b>7,153.6</b>	<b>SDR allocation</b>
<b>Aksione dhe instrumenta të tjerë</b>	<b>63,391.1</b>	<b>61,859.9</b>	<b>45,882.2</b>	<b>43,571.0</b>	<b>43,198.7</b>	<b>38,526.2</b>	<b>Shares and other equity</b>

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania